

SPECIFIKIMI I ÇMIMEVE

OBJEKTI: SISTEMIM ASFALTIM RRUGE NE NJESITE ADMINISTRATIVE 2022 FAZA II

Germim dheu seksion i detyruar me shkarkim ne mjet

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ germim i detyruar ne rruge, panvaresisht nga kategoria e tokes me mjet te mekanizuar dhe ngarkim ne mjet. Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat sipas profilave gjatesor dhe terthor te rruges.

Trasport dheu me auto deri 1 km.

Ne cmim perfshihet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per transportin e dherave ne nje vend te caktuar nga Investitori , por jo me larg se 1 km nga objekti.

Ndertim mur guri mbajtes llac cemento M 25

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ mur guri dekorativ ll.c. M=25 per ndertimin e mureve sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit . Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rere guri, cemento, gure gergelore, transportin. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e gurit. Llaci te prodhohet me betoniore ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri, te realizohet marka e kerkuare llacit.

Shtrese cakell makadam 10 cm,10/15

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese cakell 0-50 me trashesi shtrese 10 cm,dhe10/15 pas ngjeshjes me rul 12 ton duke patur parasysh kuotat ne profilat gjatesor dhe terthor te rruges, ndertimi i shtreses me cakell te behet (profilohet) me grejder dhe ngjishet me rul 12 ton duke bere dhe lagijen me uje , ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialit , transportin shperndarjen e tij ne rruge dhe ngjeshjen e tij me rul sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete cakell mbeturine gurore me perzjerje argjile jo me shume se 15 %. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e cakellit.

Shtrese stabilizant 10 cm + sperkatje me bitum

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese stabilizant makinerie me trashesi 10 cm me pjerresi sipas profilave gjatesor dhe terthor dhe sperkatje 4 kg bitum / m² duke siguruar profilimin e rruges , ne cmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve , transportin shperndarjen e tij ne siperfaqen e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Materiali duhet te jete i prodhuar me makineri me fraksion deri 30 mm , .Materiali duhet te ngjishet disa here me rul dhe kihet parasysh profilat gjatesor dhe terthor te rruges . Mbi shtresen hidhet prajmer ndertuar me bitum jo me pak se 0.5 kg per m² dhe mbi prajmerin hidhet nje shtrese granil. Shtresa te ruhet nga ndotjet . Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e cakellit.

Shtrese binder 5 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m² shtrese binder , me trashesi 5 cm pas ngjeshjes me rul 12 ton shtrimi me makineri , dhe te sigurohen pjerresite sipas profilave gjatesor dhe terthor, ne cmim futet teresia e shpenzimeve

blerjen e binderit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne kasoneten e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi i binderit te behet pasi jane pergatitur nenshtresat sipas kushteve teknike , testeve te bera te nenshtreses : Shtrimi te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Materiali i binderit te plotesoje te gjitha kushtet teknike shoqeruar me certificate cilesie.Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e binderit.

Shtrese asfaltobetoni 4 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m2 shtrese asfaltobetoni me trashesi 4 cm, pas ngjeshjes me rul 12 ton , dhe siguron pjerrsite sipas profilave gjatesor dhe terthor, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e asfaltit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne kasoneten e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi i asfaltit te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Asfaltobetoni te plotesoje te gjitha kushtet teknike , shoqeruar me certificate cilesie .Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e asfaltit.

Ndertim pusete me zgare gize per ujrane shiut. C – 16 / 20

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete shiut 0.4x0.4x1m me beton C – 16 / 20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures dhe per vendosjen e kapakun te gizes . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret i gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuare betonit.